



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.10.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i aktit normativ nr. 2, datë 02.10.2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019””
2. Shqyrtimi i aktit normativ nr. 3, datë 02.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Vullnet Sinaj, Roland Xhelilaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Krenar Ryçi, Ervin Bushati, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Sadi Vorpsi, Dritan Bici, Ismet Beqiraj, Xhevit Bushaj

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Reme Lala, Arben Elezi, Senida Mesi, Ylli Shehu, Korab Lita, Blerina Gjylameti

Të ftuar:

Anila Denaj - Ministre e Financave

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave

Mimoza Dhembli –

Endrit Lami -

Nikolla Lera -

Ilir Sallaku -

Xhoana Agolli -

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Fillojmë me shqyrtimin e aktit normativ nr. 2, datë 2.10.2019 “Për disa ndryshme në ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019””.

Relatore është zonja Antoneta Dhima.

Shqyrtimi i aktit normativ nr.3, datë 2.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar””.

Relatore është zonja Dhima.

Të ftuar: Ministrja e Financave, Anila Denaj, si dhe Mimoza Dhëmbi, Endrit Lami, Xhoana Agolli.

Për pikën 2, këtu më rezulton që do të jetë i ftuar zoti Elton Haxhi, Nikolla Lera dhe Ilir Sallaku.

Urdhëroni, relatorja, zonja Antoneta!

Antoneta Dhima – Faleminderit!

Rishikimi i buxhetit në mes të vitit buxhetor është një instrument ligjor dhe praktikë e konsoliduar ndër vite, i cili mbështetet në:

nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës; nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”; rregullat e përcaktuara në nenet 32-39 dhe kreun III të Rregullores së Kuvendit.

Akti normativ i Këshillit të Ministrave nr.2, datë 2.10.2019, “Për disa ndryshime në ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” synon të pasqyrojë, në ligjin e buxhetit vjetor, ndryshimet e ndodhura në ekonominë e vendit për periudhën 9-mujore dhe pritshmëritë për realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë e buxhetorë deri në fund të vitit, duke respektuar politikat dhe treguesit e parashikuar në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020; Programin Ekonomik dhe Fiskal 2019-2021, të hartuar dhe rishikuar në bazë të konsultimeve me Fondin Monetar Ndërkombëtar; Kuadrin makroekonomik e fiskal afatmesëm.

Arben Ahmetaj – Më falni, zonja Dhima! Mua më mungon fiskalja e re në dokumentet që keni sjellë.

Është traditë që sillet fiskalja, aq më tepër që është baza e diskutimit. Unë nuk do t'i them ministres, sill fiskalen. Këtë detyrë e ke ti, Endrit.

Më vijnë sms nga deputetët për fiksen. Duhej ta kishe sjellë. Të lutem, nisi në umeilet e deputetëve fiskalen e rishikuar!

Antoneta Dhima - Rishikimi i buxhetit të vitit 2019 u bë i nevojshëm për disa qëllime, si më poshtë:

- Për të kompensuar financimin e zërave të shpenzimeve buxhetore, që u prekën në fillim të vitit 2019, për efekt të financimit të Paktit për Universitetin;
- Për të reflektuar ecurinë pozitive të të ardhurave vendore deri në ditën e hartimit të aktit normativ;
- Për të siguruar kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 21 shtator 2019;
- Për të rishpërndarë fondet për investime drejt projekteve me ecuri më të mirë;
- Për të rishpërndarë fondet ndërmjet ministrive dhe institucioneve buxhetore, me qëllim realizimin e disa objektivave specifike, si rritja e mbështetjes për fermerët, shtresat sociale në nevojë, arsimin e lartë, rendin, mbrojtjen etj.

Paraqitja e ndryshimeve buxhetore me akt normativ të Këshillit të Ministrave është një praktikë e ndjekur prej vitesh, e cila bazohet në nenin 101 të Kushtetutës dhe në disa vendime të Gjykatës Kushtetuese. Kriteret për nxjerrjen e akteve normative janë nevoja, urgjenca dhe përkohshmëria e masave të propozuara. Në rastin konkret, ndryshimet buxhetore janë të nevojshme dhe urgjente, pasi krijojnë mundësinë për realizimin e disa objektivave të rëndësishme ekonomike e sociale, duke respektuar afatet dhe procedurat për kryerjen e prokurimeve publike. Përkohshmëria e masave të propozuara argumentohet me faktin që ato marrin fuqi brenda 45 ditëve, pra brenda datës 16 nëntor 2018, kur Kuvendi duhet të miratojë me ligj aktin normativ.

Gjatë periudhës 9-mujore, ekonomia e vendit vijoi të zhvillohet me ritme pozitive. Kjo ecuri ishte rrjedhojë e shfrytëzimit më të plotë të kapaciteteve prodhuese, rritjes së punësimit dhe pagave, si dhe përsheptimit të kreditimit të ekonomisë. Sipas statistikave të publikuara nga INSTAT-i, PBB në tremujorin e parë dhe të dytë u rrit respektivisht me 2,4 dhe 2,3 për qind. Ndikimin kryesor në këtë rritje e dha zgjerimi i aktivitetit në sektorët e shërbimeve dhe bujqësisë. Edhe për 3-mujorin e tretë, sipas të dhënave paraprake, parashikohet një ecuri e ngjashme. Por, me gjithë ritmet pozitive, gjatë 6-mujorit të parë ka një rënie të ritmit të rritjes ekonomike, kryesisht për shkak të reduktimit të prodhimit të energjisë elektrike, si pasojë e kushteve atmosferike, përfundimit të projekteve të mëdha energjetike (Gazsjellësi TAP dhe Hidrocentrali i Devollit), si dhe mbylljes së aktivitetit në shumicën e subjekteve të lojërave të fatit.

Rënia në 11,5 për qind e normës së papunësisë dhe rritja me 4,5 për qind e pagës mesatare gjatë 3-mujorit të dytë kanë krijuar kushtet për zgjerimin e kërkesës agregate dhe shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve prodhuese.

Tregjet financiare vijojnë të karakterizohen nga norma të ulëta interesi, situatë e mirë likuiditeti, qëndrueshmëri e kursit të këmbimit, trend në rritje i kreditimit dhe rënie e nivelit të kredive me probleme. Parashikimet për periudhën afatmesme janë që goditjet e ofertës të zbehen dhe rritja ekonomike të përshpejtohet.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, për periudhën 9-mujore, vlerësohen të jenë rreth 344 miliardë lekë, me një realizim të planit në masën 98 për qind. Ndikim pozitiv në këto të ardhura dhe rritja e të ardhurave tatimore me mbi 14 miliardë lekë ose 4,6 pikë përqindje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Ky rezultat në të ardhurat tatimore ishte rrjedhojë e rritjes së të ardhurave nga tatimet dhe doganat, të ardhurave nga pushteti vendor dhe të ardhurave nga fondet speciale.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, për periudhën 9-mujore, arritën nivelin rreth 345,8 miliardë lekë, me një realizim të planit në masën 96 për qind. Këto shpenzime janë rritur me 19,8 miliardë lekë ose 6,1 pikë përqindje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Akti normativ i buxhetit përmban disa karakteristika kryesore, si më poshtë:

Së pari, ruhen të pandryshuar parametrat kryesorë të buxhetit, të miratuar në fillim të vitit, duke vijuar qëndrueshmërinë e financave publike.

Akti normativ nuk parashikon ndryshime në të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, si dhe deficitin buxhetor. Niveli i deficitit buxhetor mbetet aq sa ishte parashikuar në fillim të vitit (1,9 për qind e PBB). Po kështu, borxhi publik qëndron në kufijtë e parashikuar në fillim të vitit (65,5 për qind e PBB). Bilanci primar fiskal vijon të jetë një tregues pozitiv, me sufiçit, siç ka ndodhur që prej vitit 2016, kur ky tregues u kthye nga negativ, në pozitiv .

Së dyti, mundësohet një mbështetje më e madhe për pushtetin vendor, duke rritur financimin e tij me 4 miliardë lekë. Kjo rritje e financimit të pushtetit vendor reflekton ecurinë mjaft pozitive në mbledhjen e të ardhurave vendore gjatë këtij viti. Për periudhën 9-mujore, të ardhurat nga pushteti vendor u rritën me 2,5 miliardë lekë ose 15 pikë përqindje në krahasim me planin. Rritja e financimit të pushtetit vendor do të sigurohet nga rritja e të ardhurave të veta me 3 miliardë lekë dhe rritja e financimit të huaj vendor me 1 miliardë lekë.

Së treti, sigurohet financimi i fondit rezervë të buxhetit të shtetit, i cili rritet me 450 milionë lekë. Kjo masë synon të sigurojë financimin e nevojshëm për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 21 shtator 2019.

Së katërti, sigurohet akomodimi i nevojave të reja të funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, vetingut, si nga pikëpamja e shpenzimeve, ashtu edhe e numrit të punonjësve.

Së pesti, bëhen disa rialokime të tjera midis zërave të shpenzimeve korrente.

Këto rialokime bazohen në ecurinë e 9-mujorit dhe synojnë rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit nga ministritë dhe institucionet publike, rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, si dhe reduktimin e detyrimeve të prapambetura. Shpenzimet korrente, në total, rriten me rreth 2.7 miliardë lekë. Kjo rritje, si dhe rialokimet midis zërave përkatës, do të sigurojnë mbështetje për financimin e skemës së fermerëve, skemës së paaftësisë së kufizuar, arsimit të lartë, rendit, mbrojtjes etj, si më poshtë:

- Në Ministrinë e Brendshme rriten shpenzimet me 450 milionë lekë, për pagesën e orëve jashtë orarit të efektivëve të Policisë së Shtetit, të ushqimit dhe orëve të punës për Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë dhe kursantët, si dhe 30 milionë lekë për pagat e Gjendjes Civile;

- Në Ministrinë e Mbrojtjes rriten shpenzimet me 120 milionë lekë për mirëmbajtjen e sistemit “Palantir” dhe 330 milionë lekë për misionet jashtë vendit;

- Në Ministrinë e Shëndetësisë rriten shpenzimet me 300 milionë lekë për mbështetjen e skemës së paaftësisë së kufizuar, si kompensim i financimit të Paktit të Universitetit, të dakordësuar në janar 2019;

- Në Ministrinë e Arsimit rriten shpenzimet me 300 milionë lekë për financimin e arsimit bazë, si kompensim i financimit të Paktit të Universitetit, të dakordësuar, dhe kjo në janar të vitit 2019.

Në Ministrinë e Bujqësisë rriten shpenzimet me 200 milionë lekë, për mbështetjen e skemës së fermerëve lidhur me kompensimin e çmimit të qumështit.

Së gjashti, rritet performanca e shpenzimeve kapitale, duke rishpërndarë fondet drejt projekteve të investimeve që kanë pasur histori më të mirë të punimeve të deritashme. Në ministritë dhe institucionet që mbështesin (...) janë bërë këto ndryshime:

Ministria e Integrimit European, ku shpenzimet për financimin e huaj rriten me 1 miliard lekë, për të financuar gjithashtu avancimin e punimeve të bajpasit të Fierit,

përfundimin e një krahu të rrugës, si dhe 370 milionë lekë për shpronësimin e objekteve nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ku shpenzimet do të rriten me 800 milionë lekë për avancimin e projekteve kryesore të programeve të zhvillimit.

Ministria e Kulturës, ku shpenzimet rriten me 200 milionë lekë për rikonstruksionin dhe pajisjen e godinës së Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, me qëllim përfundimin e këtij projekti brenda afateve të parashikuara.

Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, ku shpenzimet rriten me 200 milionë lekë për vijimin e financimit të punimeve të projektit për mbrojtjen e argjinaturave të lumenjve dhe sistemit të kanaleve ujitëse.

Ministria e Financave, ku shpenzimet rriten me 125 milionë lekë për blerjen e pajisjeve për polin e drejtësisë.

Ministria e Shëndetësisë, ku shpenzimet rriten me 90 milionë lekë për rikonstruksionin e godinës së maternitetit të vjetër.

Bashkia e Tiranës, ku shpenzimet rriten me 1 miliard lekë për avancimin e punimeve në projektin e bulevardit verior dhe rehabilitimin e lumit Lana.

Konkluzione:

Së pari, ndryshimi i buxhetit të vitit 2019 nëpërmjet këtij akti normativ, është me rëndësi të veçantë, bazuar në të gjitha qëllimet që unë sapo përmenda më sipër. Për periudhën e mbetur të vitit, sugjeroj që strukturat ekzistuese të rrisin më tej përpjekjet në drejtim të përmirësimit të administrimit fiskal, realizimit të detyrimeve kontraktore të projekteve të investimeve publike, thellimin e reformave strukturore, si dhe objektivave të tjera afatmesme, për të arritur rezultatet e parashikuara në treguesit makroekonomikë dhe treguesit fiskalë të vendit.

Së dyti, nga tabelat duket se nuk parashikohet bonusi për shpërblimin e pensionistëve dhe shtresave të tjera në nevojë, për festat e fundvitit, problem që është ngritur edhe nga kryetari i komisionit në mbledhjen e fundit. Ministria e Financave duhet të japë një informacion të plotë në lidhje me këtë çështje. Në aktin normativ duhet të reflektohet rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave për parashikimin e këtij shpenzimi në këtë akt normativ, me qëllim mbështetjen e këtyre shtresave të popullsisë, që janë në nevojë.

Së treti, Kuvendi i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet dy shkresave, në të cilat ka paraqitur kërkesat për rialokim të fondeve buxhetore në disa institucione. Ky rialokim kërkohet për të përballuar shpenzimet në lidhje me kremtimin 100-

vjetorit të parlamentarizmit shqiptar, i cili do të jetë më 20 janar të vitit 2020. Për këtë qëllim do të zhvillohen aktivitete jo vetëm nga Kuvendi i Shqipërisë, por edhe nga disa institucione të tjera, si Akademia e Shkencave, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Akademia e Studimeve Albanologjike, Arkivi Qendror i Filmit, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Muzeu Historik Kombëtar, Bashkia e Tiranës, Bashkia e Lushnjës, si dhe një sërë institucionesh të tjera.

Në buxhetin e vitit 2019, Kuvendi ka detajuar fondet e nevojshme për realizimin e gjithë këtyre veprimtarive, të cilat janë programuar në një kalendar, ndërsa institucionet e tjera nuk i kanë parashikuar këto fonde në buxhetet e tyre.

Për të bërë të mundur realizimin e këtyre veprimtarive, Kuvendi ka kërkuar rishpërndarjen e fondeve. Besoj se zonja ministre mund të na japë ndonjë shpjegim në lidhje me këtë.

Si përfundim, mbështetur në të gjitha këto argumente që përmenda, unë propozoj që anëtarët e Komisionit të Ekonomisë ta miratojnë këtë projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019””.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Zonja Ministre, fjala për ju!

Anila Denaj – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuara zonja e zotërinj deputetë,

Në fakt, u rehatuan shumë elementë, të cilët kanë të bëjnë si me treguesit ekonomikë e fiskalë, ashtu edhe elementë të detajuar të këtij akti normativ. Megjithatë, unë do të doja të përmbledhja dy elementë shumë të rëndësishëm. Së pari, shumë shkurt, në lidhje me situatën makroekonomike. Rritja ekonomike për gjysmën e parë të vitit 2019, e cila shënon 2, 3 %, krahasuar me rritjen e vitit të kaluar, atribuohet kryesisht nga një tkurrje e thellë e prodhimit të energjisë elektrike, që pasqyron kontrastin e fortë të situatës hidrike të këtij viti e asaj të një viti më parë, duke ndikuar me 1 pikë përqindje, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018-ës.

Më pak efekt ka pasur, por jo pa munguar, sektori i lojërave të fatit, që ka ndikuar në këtë rritje. Në qoftë se të dy këta elementë do të kishin pasur të njëjtën performancë si vitin e kaluar, sigurisht që do të flisnim me tregues të tjerë.

Kjo nuk do të thotë se duhet të mbetemi në krahasimin me vitin e kaluar dhe as në situatat e segmenteve të energjisë. Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është duke u punuar për të parë që rritja ekonomike në nivel afatmesëm të vijë nga më shumë se një sektor,

dhe struktura e rritjes ekonomike të përshpejtohet nga sektorë prioritarë, si turizmi, agroindustria e të tjerë.

Nga optika e kërkesës agregate, rritja pozitive në gjysmën e parë i atribuohet konsumit, por gjithashtu, në njëfarë mase i atribuohet dhe eksporteve neto të shërbimeve, të cilat edhe gjatë këtij viti reflektojnë një performancë të mirë të turizmit.

Nuk dua të ngelem te treguesit e tjerë, të cilët zonja Antoneta i përmendi, megjithatë po flas për disa elementë në raport me zhvillimet fiskale e buxhetore.

Të ardhurat e përgjithshme për nëntëmujo rin rezultuan në nivelin e 343, 5 miliardë lekë, me një realizim në masën 71 % të planit vjetor, ose me një ritëm rritjeje prej rreth 4, 2 %, në krahasim me një vit më parë.

Në të njëjtën kohë, shpenzimet e përgjithshme publike rezultuan në nivelin e 345, 8 miliardë lekësh, me një realizim në masën 67 %, ose me një rritje prej 6, 1 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Shpenzimet korrente rezultuan në rreth 304, 3 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet kapitale me një realizim në masën 41, 4 miliardë lekë ose 47 % të planit vjetor.

Një element të rëndësishëm përbëjnë investimet publike. Ka dallim në ekzekutim, midis shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm dhe atyre me financim të huaj. Ndërkohë që shpenzimet kapitale me financim të brendshëm kanë pasur një realizim relativisht të kënaqshëm, prej rreth 53 % të planit vjetor, në periudhën për të cilën po flasim, si dhe një rritje prej 8, 9 %, krahasuar me 2018-ën. Shpenzimet me financim të huaj kanë pasur një ecure mjaft më të ngadaltë, me një realizim në masën 38 % të planit vjetor, apo rreth 32 % më pak se nëntëmujo rin e 2018-ës.

Megjithatë, këto janë shifra paraprake. Ne synojmë që deri në fund të vitit të jemi brenda kuadrit të parashikuar në këto aspekte.

Deficiti i përgjithshëm për nëntë muajt e parë të vitit 2019 rezultoi në nivelin e 2, 3 miliardë lekëve. Në tre muajt e mbetur të vitit pritet që shpenzimet në përgjithësi, ato kapitale në veçanti, të kenë një përshpejtim të ekzekutimit të tyre, çka ndodh veçanërisht në muajt nëntor-dhjetor. Ky është një trend i të gjithë viteve të kaluar, kështu që nuk do të mund të bënte përjashtim as ky vit.

Në aspektin makrofiskal, niveli i deficitit pritet të konvergojë drejt nivelit ligjor të targetuar, sigurisht në respektim të plotë të këtij targeti prej 1, 9 % të produktit të brendshëm bruto.

Mbetemi me besim se edhe ky buxhet do të mbyllet me një balancë primare pozitive, tregues i cili, është kthyer tashmë në një lloj objektivi operacional i politikës fiskale, që prej vitit 2016, dhe patjetër që është tejet e rëndësishme që të vijojë të jetë i tillë.

Po ashtu, edhe parametri më themelor i qëndrueshmërisë së financave publike, raporti i borxhit publik ndaj produktit të brendshëm bruto, pritet të vijojë në reduktimin tij, kryesisht në linjë me objektivat e shpallura më parë.

Në lidhje me aktin normativ dhe çfarë ai synon, unë nuk do të doja të bija në përsëritje të atyre që u thanë nga zonja Antoneta, por megjithatë, është shumë e rëndësishme të theksojmë se grupet që janë synuar për t'iu adresuar vëmendje ky akt normativ, kanë qenë jo vetëm analiza e performancës së projekteve me ritëm të ulët të zhvillimit të shpenzimeve, kryesisht të shpenzimeve kapitale dhe korrente, që kanë pasur një zhvendosje drejt performancës së zërave buxhetorë, të cilët kanë qenë më mirë se të tjerët.

Është e rëndësishme të themi edhe se janë dhënë rialokime, për të vendosur një theks tek katër shtylla kryesore. Së pari, ajo që u përmend më përpara, Policia e Shtetit dhe pagesat e orëve jashtë orarit, poli i drejtësisë, në lidhje me elementët që u thanë pak më sipër, Ministria e Mbrojtjes për elementë që lidhen me obligimet tona ndaj NATO-s, me elementë të tjerë shtesë, të cilat kanë të bëjnë me rialokime për strukturime të nevojshme, si dhe Fondi Rezervë, i cili sigurisht, në shtesën që u bë së fundmi, synon edhe mbështetjen e disa zërave të fondit të emergjencës në vijim, pas daljes së të gjitha efekteve të Fondit të Emergjencës mbas vlerësimit të dëmeve.

Në përfundim, të nderuar deputetë, ju ftoj të gjithëve që ta miratoni këtë akt normativ. Në vijim, jemi të hapur për çdo pyetje.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Ka pyetje?

Po, ju lutem!

Anila Denaj – Më falni, zoti kryetar, unë nuk u dhashë përgjigje dy pyetjeve të zonjës Antoneta, por ndoshta përgjigjem pak më vonë.

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, nëse doni mund ta bëni tani!

Anila Denaj – Dakord!

Në raport me zërat buxhetorë që u theksuan, për të përmbushur edhe detyrimet ndaj festave kombëtare, ne i kemi marrë parasysh. Ndërkohë, në lidhje me pensionet, sigurisht që Ministria e Financave do të analizojë kërkesën e bërë nga ky komision. Kjo kërkesë ka ardhur më vonë, pra pasi ky akt normativ qe përpunuar. Ne do të shikojmë të gjitha vlerësimet që kanë të bëjnë me zërat e shpenzimeve, dhe gjatë muajve në vijim, në rastin më të parë që do

të kemi për të alokuar këtë fond, do ta bëjmë të mundur. Kjo është pjesë e analizës së tremujorit të ardhshëm, ndaj është shumë e parakohshme të themi që sot se do ta marrim parasysh. Kuptohet, në bazë të performancës së treguesve, kjo do të ketë një vëmendje edhe më të shtuar.

Ndjesë, se zotin Haxhi e kishim në një aktivitet tjetër, por shpresoj të jetë edhe në këtë pikë të parë të diskutimit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Zonja Ministre,

Faleminderit që keni ardhur në komision!

Prisja të shikojë këtu, në këtë akt normativ, edhe një pjesë të dëmshpërblimit të ish- të përndjekurve politikë, ndaj pyetja që më shqetëson, është: pse nuk e keni parashikuar një gjë të tillë?

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zonja Ministre!

Anila Denaj – ... 200 milionë lekë në këtë zë, brenda buxhetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Sigurisht, këto do të shkojnë për të përshpejtuar pagesat e këtij grupi.

Arben Ahmetaj – Jo pa leje, zoti Roshi.

Artur Roshi – Kam pyetje tjetër.

Arben Ahmetaj – Ke pyetje tjetër? Bëji të gjitha pyetjet! Ministrja i mban shënim, e pastaj u përgjigjet.

Artur Roshi – Dakord!

Me këtë hap që ju keni, i bie që kjo të mbarojë pas tridhjetë vjetësh.

Arben Ahmetaj – Lëri komentet! Bëj pyetjet! Më fal zoti Roshi, një sekondë!

Artur Roshi – Më pas do të bëj pyetjen.

Arben Ahmetaj – Bëj pyetjen, mos bëj komente, sepse ka rregull!

Artur Roshi – Kur të bëhen komentet në fund, ikin mediet...

Arben Ahmetaj – Po ne nuk punojmë për mediet, zotëri!

Artur Roshi – Po nuk dua të flas me pasqyrën. Dua të flas me publikun.

Po të jetë për të folur me pasqyrën, flas në shtëpi dhe nuk vi fare.

Arben Ahmetaj – Në qoftë se nuk ke pyetje, ok, në rregull! Komentet do të bëhen kur t'u vijë radha.

Ju lutem, zonja Evis!

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Një nga treguesit kryesorë se si performon një ekonomi, është padyshim rritja ekonomike, dhe ju, zonja Ministre, e nisët fjalën tuaj pikërisht me këtë tregues.

Siç i kemi të dhënat edhe nga institucionet e tjera, 2, 2 % ishte rritja ekonomike në tremujorin e parë, ndërsa në tremujorin e dytë 2, 3 %. Ju i argumentuat edhe arsyet në lidhje me këtë rënie ekonomike, që fillonte me tkurrjen e prodhimit të energjisë elektrike, mbylljen e lojërave të fatit etj. Unë do të doja të dija se cilat janë parashikimet tuaja për pjesën e mbetur të vitit. Domethënë, si parashikohet rritja ekonomike, dhe a do të arrijmë që në fund të vitit ta përmbushim atë objektiv që kemi parashikuar në buxhet, sa i takon rritjes ekonomike, apo jo?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre!

Anila Denaj – Është e vërtetë se analiza e treguesit të gjashtëmujorit është bërë. Sigurisht, analiza është derivati i një procesi jashtë mundësie për t'u ndjekur që ditën e parë. Është jo vetëm derivat i kushteve natyrore, por edhe i strukturës prej së cilës vjen rritja ekonomike. Megjithatë, të flasim për një rritje të rishikuar ekonomike, mendojmë se është e parakohshme. Sigurisht, FMN-ja ka bërë një vlerësim të tillë, duke rishikuar për të dytën herë ritmin e rritjes ekonomike: nga 3, 5 që e bëri në muajin prill, janë 2, 9 që e bëri një muaj më parë. Ne do të thoshim e është ende herët për të parë e për të rishikuar këtë tregues. Këtë kohë të këtij tremujori të tretë do ta vlerësonim si një tregues kyç për të bërë rivlerësimin. Mendoj se është e parakohshme.

Arben Ahmetaj – Pyetje të tjera?.

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Keni parashikuar 200 milionë lekë për shembjen e teatrit...

Më dëgjoni, zonja Ministre? Pra, për Ministrinë e Kulturës, në lidhje me shembjen e teatrit. A është e nevojshme kjo? Cili do të jetë impakti i kësaj për ekonominë? Se ne presim impakte pozitive. Nuk mund të harxhojmë para vetëm për të shembur, dhe pastaj të themi se paska impakt pozitiv.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zonja Ministre!

Anila Denaj – Më falni, por është keqkuptim nga ana juaj, zoti Roshi, sepse është fjala për Teatrin e Operas dhe Baletit, dhe është pjesë e rivlerësimit të konstruksionit të tij. Nuk ka të bëjë me Teatrin Kombëtar.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Pra, për sqarim, zoti Roshi, është një projekt i nisur katër vjet më parë. në rivlerësim punimesh, siç u referua edhe ministrja, duhen edhe 200 milionë lekë. Ka qenë parashikuar me fondin grek. Fondi grek nuk është realizuar, megjithëse ato 2 milionë euro vazhdojnë të jenë aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është prishje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, më falni, nuk ka nevojë! Nuk është prishje, por ndërtim. Nuk ka të bëjë me atë fiksimin tuaj të teatrit, por ka të bëjë me Teatrin e Operas dhe Baletit. Është godinë krejt tjetër. Mos u fiksoni te ajo godinë. Dilni një sekondë nga ajo godinë.

Ka pyetje tjetër?

Po, ju lutem!

Krenar Ryci – Faleminderit, zoti kryetar,

Faleminderit, zonja Ministre, që jeni e pranishme sot këtu,

Arben Ahmetaj – A mund ta çoni zërin, ju lutem?

Krenar Ryci – Po.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Krenar Ryci – Unë dua të bëj dy pyetje. E para: Ju thatë se, si tremujor, në sektorin e turizmit ka pasur një rritje prej 2, 3 %. Po në sektorë të tjerë të ekonomisë, që ju i keni në varësi, ka pasur rritje apo këta sektorë nuk janë rentabël?

E dyta: mbyllja e lojërave të fatit, meqenëse u mbyllën në mënyrë të shpejtë, a ka ndikuar sadopak në ekonominë dhe në buxhetin e shtetit?

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre!

Anila Denaj – Sa i takon rritjes ekonomike në raport me disa sektorë të tjerë, më lejoni të jem konkrete me shifra. Përtej dy elementëve që përmendëm në fillim, të cilat ndikuan në mënyrë negative, evidentohen rritje relativisht të forta në sektorin e industrisë nxjerrëse, me rreth 15, 6 %, por edhe të industrive të tjera përpunuese, me rritje që variojnë nga 4, 4 % për industrinë e prodhimit të veshjeve, tekstileve e këpucëve, në rritje prej 15, 6 % për industrinë e prodhimit të produkteve të drurit, letrës e të tjera.

Gjithashtu, ka pasur rritje të qenësishme pozitive, që variojnë nga 4, 8 % në 13, 9 % në pjesën më të madhe të sektorëve të shërbimeve, që nga tregtia, akomodimi dhe shërbimi ushqimor, transporti, informacioni, komunikacioni, aktivitetet financiare, si dhe aktivitetet e pasurive të paluajtshme.

Këto ishin për pyetjen e parë.

Ju kërkoj ndjesë, por a mund të ma përsërisni pyetjen e dytë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ka ndikuar, me një ritëm të caktuar përqindjeje, por efekti pozitiv social prevalon mbi ndikimin negativ të këtij viti të parë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Ka pyetje të tjera?

Po, ju lutem Suzana!

Suzana Topi – Përsëritet!

Zonja Ministre, doja të bëja një pyetje: A parashikoni se ky akt normativ për buxhetin e vitit 2019, do të ndikojë në borxhin e brendshëm në fundvitin e 2019-ës?

Arben Ahmetaj – Ndjesë, por cila ishte pyetja, që ta dëgjojnë të gjithë?

Suzana Topi – Ky akt normativ a do ta ndryshojë nivelin e borxhit publik në fund të vitit 2019?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ka pyetje të tjera?

Atëherë kam unë disa pyetje, zonja Ministre!

Pyetja e parë: sa është efekti i reduktimit të gjendjes në arkë, në llogarinë e qeverisë, në uljen e borxhit publik, 31 dhjetor 2018-31 dhjetor 2019, në përqindjen e prodhimit të brendshëm bruto?

Pyetja e dytë: sa është goditja e energjisë në rritjen gjashtëmujore? Është llogaritur nga INSTAT-i apo është në diskutim brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë?

Pyetja e tretë: cila është arsyeja e uljes së investimeve publike me 3 miliardë, ndërkohë që, sipas dijenisë sime, janë akoma *rear* në infrastrukturë rreth 6, 2 miliardë?

Sa është TVSH-ja bruto, nëntëmujori i vitit 2018, krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2019?

Sa është importi i energjisë për këtë periudhë, krahasuar me importin e energjisë për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar?

Sa është numri i të punësuarve në sektorin jobujqësor për të njëjtat periudha respektive?

Faleminderit!

Anila Denaj – Do të jap një përgjigje të koordinuar me përgjigjen për kolegët. Goditja e energjisë në rritjen ekonomike, gjë që e përmenda pak më parë, sipas analizës së bërë brenda ministrisë, por edhe referuar të dhënave të INSTAT-it, ka qenë me 1 pikë

përqindje. Investimet publike, sigurisht janë të ulura në raport me analizën e performancës. Kjo është e lidhur edhe me analizën e detyrimeve të prapambetura. Është një proces analize me të gjitha ministritë e linjës, për të parë rolin e secilës ministri në pagesat e detyrimeve të prapambetura, në radhë të parë, pastaj edhe të vijueshmërisë me investimet.

Megjithatë, besoj se ky nuk është një proces që bëhet sot për herë të parë. Një situatë e tillë në analizë *rear* dhe investimesh publike ka ndodhur çdo vit. Në obligimin e Ministrisë së Financave është bërë adresimi i të dyjave paralelisht, si i investimeve me performancë të ulët, ashtu edhe ndjekja në mënyrë rigoroze e çdo pagese të *rears* në vijim. Për pjesën e energjisë dhe efektin e reduktimit të uljes së borxhit publik, po ia kaloj zotit Lami.

Endrit Lami – Për sa i takon borxhit publik, efekti i reduktimit të TSA-së, pra llogarisë unike të thesarit, që bën edhe diferencën midis borxhit publik bruto dhe borxhit neto, për vitit 2019 është 2 pikë %.

Arben Ahmetaj – Paratë e gjetura në llogarinë e qeverisë për shkak të eurobondit më 31 dhjetor të vitit 2018...

Endrit Lami - Të siguruara jo të gjetura.

Arben Ahmetaj - Paratë e siguruara nga eurobondi të lëna në orën 12:00, më 31 dhjetor të vitit 2018, duke i harxhuar qeveria në legjimitetin të saj, e ul borxhin në 2%.

Endrit Lami – Po, e saktë.

Arben Ahmetaj – Apo nuk është kështu?

Endrit Lami - E saktë.

Arben Ahmetaj – Pra, vetëm nga ulja e TSA-së borxhi do të ulet 2%. Domethënë, paratë e gjetura në llogari, duke i harxhuar për shpenzime publike, në bazë të ligjit, ulin borxhin në 2%.

Endrit Lami – Po.

Arben Ahmetaj – Zoti Lami, po në parashikimin tuaj (nuk e kam për ministren këtë pyetje) sa do të jetë efekti i kursit në uljen e borxhit?

Endrit Lami - Varet si do të shkojë, sepse ju e dini që kalkulohet me kursin e fundvitit.

Arben Ahmetaj – Sigurisht, por unë po bëj një pyetje, në referencë të parashikimit.

Endrit Lami - Në qoftë se kursi do të ishte siç është sot edhe më 31 dhjetor, efekti do të ishte rreth 0,5% deri në 1 pikë %.

Arben Ahmetaj – Domethënë, për rekorde midis komisionit dhe ministrisë, që nuk e po e marr 1%, por po e marr 0,5%; 2,5% është ulja artificiale e borxhit brenda vitit 2019, apo jo?

Endrit Lami - Po, për vitin 2019 është 2,5%, por nuk është artificiale.

Arben Ahmetaj – Është pa përpjekje.

Endrit Lami - Janë bërë përpjekje më parë.

Arben Ahmetaj – Po kështu bëhet, kështu ndodh gjithmonë dhe kjo është logjika.

Faleminderit!

Pra, zonja Ministre, për rekordet e komisionit, thatë se është 1% goditja e energjisë e llogaritur nga ju apo nga INSTAT-i?

Anila Denaj – E llogaritur nga ne në bazë të...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, a mund të na vini në dispozicion përllogaritjen me shkrim?

Endrit Lami - Patjetër.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjet.

Urdhëroni!

Anila Denaj – Në raport me TVSH-në, shifrat do t'i relatojë zoti Haxhi.

Më lejoni të theksoj se TVSH-ja neto për këtë vit ka tregues, të cilët marrin për bazë efektin e rimbursimeve të TVSH-së, të paktën me 4,3 miliardë më shumë se viti i kaluar. Megjithatë, për një detajim më të gjerë zoti Haxhi do të japë përgjigje për TVSH-në.

Arben Ahmetaj – Jo më kot pyeta për TVSH-në bruto, sepse është treguesi i efektivitetit të administratës dhe rritjes ekonomike.

Pyetja ime: cila është arsyeja e uljes së investimeve publike? Ndërkohë që ka 6,2 miliardë *rears*, *rears* nuk janë një fenomen i ri, besoj se është një fenomen disavjeçar, por në rastin konkret pyetja ime shkon në një drejtim specifik, zonja Ministre, sepse, duke qenë se jua njoh vështirësinë në këtë debat me kolegët tuaj, sugjerimi im tashmë është i vonë. Ai 3-miliardëshi duhej të mos ulej nga investimet publike, por të kalonte për pagesat *rears*, pavarësisht se si kanë ecur projektet e tjera. Meqëqëse ju jeni ministria përgjegjëse, qoftë përballë FMN-së, qoftë përballë opinionit publik për *rears*, sugjerimi do të ishte të mos uleshin investimet publike, por, sipas përllogaritjes suaj, ju mendoni se këto nuk do të harxhoheshin. Besoj se do të krijohen *rears* edhe me projekte të tjera, sepse kam referenca nga institucionet dhe do të ishte në të mirën e buxhetit dhe tuajën që këta 3 miliardë të mos ta kishit shkurtuar, por t'ia kishit kaluar pagesë për të gjitha detyrimet potenciale të prapambetura.

Pyetja tjetër: sa është TVSH-ja bruto, meqenëse ministrja autorizoi zëvendësministrin?

Ndjesë, zonja Ministre!

Anila Denaj – Unë e vlerësoj sugjerimin tuaj, është i saktë dhe i drejtë. Sigurisht, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përpjekjekur të adresojë *rears*-ës, ose detyrimet e prapambetura, si një obligim i parë përpara shkurtimeve. E vlerësoj shumë komentin që ju dhatë pak më parë, sepse është në ndihmë të ministrisë sonë, por është një proces që shkon paralelisht dhe këtë gjë doja ta komentoja.

Të njëjtën gjë e reflektuam në raport me ARRSH-në në fillim të vitit, ku hapja e buxhetit për këtë ent u bë duke vendosur detyrimet e prapambetura, si pjesë kryesore përpara të tjerave, si shembull.

Arben Ahmetaj – Ministre kam merakun se në fund të vitit, si ministre përgjegjëse do ta keni ju këtë në kurriz, pavarësisht se nuk i krijoni ju *rears*.

Unë do t'ju sugjeroja që mos e kishit bërë këtë ulje, por t'i kishit alokuar. Gjithsesi, ky është një sugjerim i vonë, po ta kishit pyetur komisionin më parë, dhe t'i thoshit që e kishit këtë 3-miliardëshin për ta shkurtuar, ne duhet t'ju kishim sugjeruar të njëjtën gjë, që po ju sugjerojmë sot. Gjithsesi, ky është një postfaktum, por *rears* do t'ju vijë në fund të vitit përballë me tryezën tuaj, pavarësisht se ju nuk jeni as personi dhe as institucioni që i krijoni këto *rears*, pra detyrime të prapambetura.

Faleminderit!

Zoti Haxhi, TVSH-ja bruto?

Elton Haxhi – TVSH-ja bruto, krahasuar 9-mujor me 9-mujor 2018-2019...

Arben Ahmetaj – Thjesht 9-mujor 2018 ka qenë kjo shifër.

Elton Haxhi – Në 9-mujorin e vitit 2018 ka qenë 115,6 miliardë, kurse në vitin 2019 është 115,2 miliardë. Ka një diferencë prej 400 milionësh.

Arben Ahmetaj – Në rritje?

Elton Haxhi – Në ulje, e cila është si efekt i përjashtimeve, që kemi bërë në paketën e vitit 2019.

Arben Ahmetaj – Çfarë përjashtimesh?

Elton Haxhi – Kemi bërë përjashtime për nënproduktet bujqësore, të cilat e kanë dhënë efektin në vitin 2019.

Arben Ahmetaj – Sa?

Elton Haxhi – 1,2 miliardë.

Arben Ahmetaj – 1, 2 miliardë është totali?

Elton Haxhi – Po.

Arben Ahmetaj – Ia dërgoni me shkrim, të përlogaritur produkt më produkt, komisionit brenda kësaj jave.

Elton Haxhi – Po.

Arben Ahmetaj – Meqenëse e lidhët me përjashtimet, sa është importi i energjisë 9-mujor më 9-mujor?

Anila Denaj – Nuk i kemi, por mund t’ia çojmë sot komisionit.

Arben Ahmetaj – Mendoj se në fund të takimit, mund t’i shkruani doganës dhe t’jua dërgojë dogana, zoti Haxhi, deri në fund të diskutimit, për t’iu referuar edhe balancës që bëtë për TVSH-në.

Sa është numri i të punësuarve në sektorin jobujqësor, në bazë të statistikës së fundit vit më vit?

Anila Denaj – Jua sigurojmë brenda ditës së sotme.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Këto ishin pyetjet.

Anila Denaj – Një analizë të TVSH-së ne mund ta sigurojmë që tani, sepse e kemi, megjithatë, brenda konfirmimit të komisionit, mund ta qarkullojmë edhe me *email*.

Arben Ahmetaj – Patjetër, do i lutesha sekretarisë që ta marrë analizën, ndërkohë, zoti Haxhi, shifrën e importit të energjisë, të krahasuar vit pas viti, e dua deri në fund të mbledhjes. Kështu që kombinohuni me Arlindin, besoj se Arlinid i ka dorazi.

Pra, do të presim përgjigje për pyetjet.

Vazhdojmë me opinione, komente dhe qëndrime. Nuk ka.

Zonja Ministre, meqenëse komisioni nuk ka qëndrime unë kam një koment.
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam harruar një pyetje, por dua që të ma dërgoni më pas në komision. Nuk është nevoja ta diskutojmë, sepse i drejtohet drejtpërsëdrejti Endritit. Endrit, keni përlogaritur nominalen, prodhimin e brendshëm në rënie, apo nuk është kështu? Domethënë, e shikoj te tabela e re që ka qenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ta bëj pyetjen që të më kthesh përgjigje.

Pra, keni parashikuar në GDP-në nominale rënie nga 1,752 në 1,717, që i bie diku te 400. A keni rënë dakord me Fondin Monetar për këtë përlogaritje, apo është parashikimi i Ministrisë së Financave? Ku e mendoni rënien kryesore nominale?

Endrit Lami – Me Fondin Monetar Ndërkombëtar ne diskutojmë kryesisht gjatë misionëve. Patjetër, kemi edhe diskutime jashtë misionëve, për aq kohë që nuk kemi

program. Ajo çfarë ne rakordojmë me Fondin Ndërkombëtar Monetar, që e kemi edhe detyrim ligjor falë rregullave fiskale që kemi në ligjin organik të buxhetit, është që në çdo ligj të buxhetit ose rishikim të tij, siç është edhe ky, patjetër që prodhimi i brendshëm bruto nominal, mbi të cilin bazohet ai buxhet ose ai rishikim, të jetë jo më i lartë se PPB-ja nominale respektive që Fondi Monetar: dhe kjo verifikohet formalisht.

Arben Ahmetaj – Zoti Endrit, çfarë po thua?! Po të pyes për një gjë specifike, nuk po të pyes për rregullin që e kam shkruar vetë në ligj, apo jo?

Endrit Lami – Patjetër.

Arben Ahmetaj – Ti më thua rregullin që kam shkruar vetë në ligj?! Unë po them pse nga 1,757 është 1,712.

Endrit Lami – Kjo është pjesa e dytë e pyetjes.

Arben Ahmetaj – Unë bëra vetëm një pyetje.

Endrit Lami – Bëtë dy pyetje...

Arben Ahmetaj – Të lutem, Endrit!

Endrit Lami – Kryesoja vjen nga deflatori dhe një pjesë vjen nga rishikimi i rritjes.

Arben Ahmetaj – Pse ka ndryshuar deflatori?

Endrit Lami – Faktiku për 6-mujorin nga INSTAT-i është shumë më poshtë se sa fillestari. Kështu, është reflektimi i tij.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Besoj se Fondi ka rënë dakord me ju për këtë logjikë, apo ende nuk keni hyrë në këtë diskutim?

Endrit Lami – Jua thashë, me fondin ne diskutojmë... Ju e dini më mirë nga të gjithë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre për përgjigjet dhe për qëndrimet! Unë e kuptoj shumë mirë punën e vështirë që keni dhe e kuptoj edhe nga shifrat se sa të vështirë dhe ngarkesë keni në punën tuaj. Ajo që dua të theksoj: është bërë një punë shumë e mirë me të ardhurat, sidomos me të ardhurat nga dividendi, ka funksionuar politika, megjithëse pasive, që vendosëm vitin e kaluar. Ka bërë një kërcim të konsiderueshëm prej gati 8 miliardësh deri në 10 miliardë plus, në krahasim me traditën, gjë që ka garantuar një qëndrueshmëri dhe ka kompensuar atë që ndodh me TVSH-në për ato arsye që ju iu referuat, edhe në fjalën tuaj. Besoj se jemi të mirëkuptuar me njëri-tjetrin, që investimet publike nuk i bëni ju, por i bëjnë kolegët tuaj, pra i ekzekutojnë kolegët tuaj. Por 47% është një nivel goxha mbrapa dhe besoj se u bëni përditë presione kolegëve tuaj për të ecur me investimet publike, aq më tepër që rritja ekonomike ka nevojë të furnizohet nga sektorë të tjerë. Në dijeninë time statistikore, sidomos ndërtimi ishte me rënie në 3-mujorin e dytë të 6-mujorit të parë. Kështu që do t'ju

lutesha që t'i shtyni kolegët, në traditë të asaj që bënë ministri i Financave të avancojnë me investimet publike.

Gjithashtu, shqetësimi im është që, në bazë të ligjit, në datën 15 tetor nuk ka më hapje prokurimesh të reja. Besoj se keni nevojë të bëni një analizë me veten tuaj, por edhe me kolegët, për të parë se deri ku do të shkojë llogaria kapitale ekzekutuar. Ndërkohë, meraku është ai që ju e keni përditë, që unë jua njoh, që janë *rears*, pra janë detyrimet e prapambetura.

Dua të theksoj atë që theksoi edhe zonja Dhima, është traditë, por besoj se edhe ju na i keni lexuar, tani që jeni anëtare e qeverisë atë qëndrim politik që ka maxhoranca, Partia Socialiste, për shpërblimin pensionistëve në fund të vitit. Ne kemi marrë angazhim politik dhe financiar dhe tashmë është kthyer në traditë që shpërblimi i pensionistëve dhe i familjeve në nevojë është pjesë e politikës financiare-fiskale e qeverisë, e Kryeministrit në fund të vitit.

Në të njëjtën kohë, dua t'jua bëj një alert për sa i përket balancimit që bëni me investimet publike të pushtetit qendror, reduktimin e tyre dhe më pas avancimin e pushtetit vendor, për shkak të avancimit të të ardhurave. Mos harroni që ka ardhur koha të mendohet ndryshe. Ne jemi në dispozicionin tuaj në qoftë se do të na kërkonin ndihmë. Ky problemi i disarmonizimit në një vit fiskal patjetër që duhet të pastrohet për të filluar nga zero. Por që të fillojë nga zero (ju keni punonjës shumë të mirë, që merren me pushtetin vendor), duhet që standardet e menaxhimit të financave vendore të vijnë në një nivel të caktuar që të mos krijohet "*moral hazard*" gjatë gjithë kohës.

Këto ishin ato që doja të ndaja me ju.

Para se të kalojmë në votim, dua të them se shumë shpejt do të fillojnë diskutimet për buxhetin e vitit 2020, do t'ju lutesha që para se të sillni buxhetin, dhe besoj se keni kohë deri më 25-30 tetor, pak a shumë, se nuk e kemi të prerë me thikë datën, të na vijë edhe një parashikim për të ardhurat. Para se të fillojmë diskutimin e buxhetit, zonja Ministre, dua që me komisionin të bëjmë një diskutim të mbyllur, pa kamera, për parashikimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve deri në fund të vitit, që më pas, kur ju të prezantoni buxhetin, komisioni të jetë pak më i qartë se çfarë trajektore jemi duke marrë.

Faleminderit!

Kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord me aktin normativ nr. 2, datë 02.10.2019 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019"? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Të përgatitet raporti për t'ia kaluar seancës plenare.

Zonja Ministre, faleminderit!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.10.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i aktit normativ nr. 3, datë 02.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Vullnet Sinaj, Roland Xhelilaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Sadi Vorpsi, Dritan Bici dhe Ismet Beqiraj, Xhevit Bushaj

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Reme Lala, Arben Elezi, Senida Mesi, Ylli Shehu, Korab Lita dhe Blerina Gjylameti

Të ftuar:

Anila Denaj – Ministre e Ekonomisë dhe Financave

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave

Mimoza Dhembli -

Endrit Lami –

Ilir Sallaku -

Xhoana Agolli -

Arben Ahmetaj – Vazhdojmë me shqyrtimin e aktit normativ nr. 3, datë 02.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Artur Roshi – Për procedurë.

Arben Ahmetaj – Nuk jeni në seancë, të lutem! Kjo është vetëm në seancë.

Artur Roshi – Po kur e merr fjalën Gjylameti për procedurë?

Arben Ahmetaj - E ka të gabuar.

Artur Roshi – Po, pse ia jep fjalën?!

Arben Ahmetaj – E ke inatin me Gjylametin? Sot nuk është këtu.

Urdhëroni, zoti Roshi.

Artur Roshi – Nuk ka lidhje me X-in që për mua është emër, nuk është person.

Unë them ta lëmë ironinë në komision. Pse ta lëmë ironinë?! Sepse nuk kemi ardhur këtu të bëjmë debat me njëri- tjetrin, ne kemi ardhur këtu të bëjmë debat rreth asaj që i shqetëson qytetarët. Kështu që të kërkoj ta tërheqësh atë ironi që bëtë qëparë.

Arben Ahmetaj - E drejtë, faleminderit!

E tërheq.

Vazhdojmë me e aktin normativ nr. 3.

Urdhëroni!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenin...

Arben Ahmetaj - Zoti Roshi, mos i ndërhyri relatores, ju lutem!

Antoneta Dhima – Përmes kësaj dispozite, Kushtetuta ka vlerësuar mundësinë e prezencës së rrethanave specifike të nevojës dhe urgjencës duke përcaktuar se Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit për marrjen e masave të përkohshme.

Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve, nëse nuk është mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Akti normativ nr. 3, datë 02.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, aktualisht është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 137 dhe Kuvendi është brenda afateve kushtetuese për ta shqyrtuar atë.

Qëllimi i aktit normativ është përjashtimi nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë për investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të

destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore. Kjo nismë ligjore ka marrë shkas nga situata e krijuar si pasojë e dëmtimeve të pësuar në shumë banesa pas tërmetit të datës 21 shtator 2019, dëmtime të cilat janë evidentuar dhe identifikuar si të tilla nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Në këto kushte, ndërhyrja e shtetit për pajisjen e menjëhershme me lejen e ndërtimit përkatës dhe me fillimin e punës për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e banesave të dëmtuara, është dhe përbën realisht një nevojë dhe situatë emergjente, pasi nevojitet që sa më shpejt të jetë e mundur të gjithë banorët e prekur nga këto dëmtime, të sistemohen në banesa dhe t'ju nënshtrohen kushteve normale të jetesës.

Kjo nevojë dhe urgjencë bëhet akoma dhe më e evidente duke ditur se dimri është afër dhe ndërhyrja së më shpejt për të evituar vijimin e kësaj situatë në periudhën e dimrit është një domosdoshmëri për qeverinë dhe për organet e vetëqeverisjes vendore.

Për sa më sipër, vlerësoj se nuk ka asnjë dyshim që aktualisht ndodhemi para kushteve të nevojës dhe urgjencës. Në këto kushte janë plotësuar të gjitha kushtëzimet e përcaktuara në nenin 101 të Kushtetutës.

Për të mundësuar përcaktimin e kushteve, rregullave dhe dokumentacionit të nevojshëm për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, Këshilli i Ministrave do të procedojë me miratimin e vendimit përkatës.

Miratimi i aktit normativ nga Këshilli i Ministrave ka shkurtuar së ndjeshmi kohën e ndërhyrjes dhe ndërmarrjen e masave nga bashkitë për të proceduar për eliminimin e pasojave.

Në rast se nisma do të paraqitej si një projektligj i propozuar nga Këshilli i Ministrave në rrugë normale si të gjitha projektligjet e tjera, koha në dispozicion të Kuvendit për ta miratuar atë, si dhe procedurat e mëtejshme të parashikuara në Kushtetutë për miratimin dhe hyrjen në fuqi të aktit, do të vononin së tepërmi ndërmarrjen e masave emergjente dhe të nevojshme për qytetarët.

Gjithashtu, theksoj se ky akt normativ ka përcaktuar dhe mundësuar zgjidhjen e përhershme të rasteve të ngjashme që mund të ndodhin në të ardhmen përmes parashikimit të përjashtimit nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për investimet e destinuar për qëllime banimi, të cilat kanë si qëllim ndërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, që mund të ndodhin edhe në të ardhmen.

Kjo iniciativë është në përputhje edhe me frymën e transmetuar përmes nenit 59 të Kushtetutës lidhur me objektivat sociale të saj.

Akti normativ përbëhet gjithsej nga 3 nene. Në nenin 1 parashikohet që investimi për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile, do të përjashtohen nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Në nenin 2 të këtij akti parashikohet shtimi i një dispozite kalimtare në ligjin nr. 6932, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, për përjashtimit nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të të gjithë personave që aplikojnë për t’u pajisur me leje për ndërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, si pasojë e tërmetit të fuqishëm të datës 21 shtator 2019.

Në nenin 3 parashikohet hyrja në fuqi e aktit normativ. Efektet e të ardhurave dhe të shpenzimeve nga zbatimi i aktit normativ do të përfshihen në programin e miratuar të buxhetit për institucionet qendrore dhe ato vendore.

Për të gjitha sa theksova më sipër, duke vlerësuar se miratimi i këtij akti normativ ishte nevojë dhe urgjencë e qeverisë për mundësimin dhe marrjen e masave emergjente për rastet e një fatkeqësie natyrore, siç ishte tërmeti i para pak kohëve, të nderuara kolege dhe kolegë deputetë, ju ftoj ta miratojmë atë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Ministre, keni ndonjë gjë për të shtuar përtej relatimit?

Ka ndonjë pyetje?

Antoneta Dhima – Zonja Ministre, kam dy pyetje: e para, a ka përfunduar evidentimi i banesave të dëmtuara dhe a ka një preventiv paraprak të numrit të banesave, të cilat kanë nevojë për t’u rindërtuar, riparuar apo restauruar?

E dyta, a janë miratuar aktet nënligjore për të mundësuar aplikimin e këtij akti normativ? Nëse jo, kur mendoni se do të miratohet?

Faleminderit!

Anila Denaj – Në fakt, evidentimi i banesave ka filluar që në momentin e parë dhe është një angazhim i të gjitha strukturave qoftë i pushtetit vendor, ashtu edhe qendror në të gjithë Shqipërinë që në momentin e parë që ndodhi situata e tërmetit.

Një vlerësim final formal ne nuk e kemi në dispozicion sot nga drejtoria përgjegjëse për të dorëzuar një relacion të tillë dhe për të vlerësuar çeljen e fondeve, por ka evidentim të elementeve, të cilët ndahen në tri grupe: riparime, godina që kanë pasur probleme strukturore, apo shtëpi banimi, të cilat, në vëmendjen e Kryeministrit, janë duke u adresuar në formate të ndryshme, duke filluar nga angazhimi i strukturave jo vetëm lokale në nivel të bizneseve, por

edhe ndërkombëtare, të cilat, së fundi, kanë treguar një interes të shtuar për të mbështetur qeverinë shqiptare me fonde buxhetore. Sigurisht, ne do t'ju vëmë në dispozicion çdo evidencë formale që do të vijë.

Në raport me aktet nënligjore, vendimi i Këshillit të Ministrave është miratuar dhe për këtë ka edhe elemente të tjera, por ky është akti juridik, i cili e vendos këtë detyrim të aplikohet. Në nenin 1 të këtij akti normativ përcaktohen rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtim nga detyrimi i pagesës së taksës së infrastrukturës, përcaktuar me VKM, që është në përgatitje.

Arben Ahmetaj – Ka pyetje? Po, zoti Vullnet.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, kryetar!

Duke vlerësuar këtë ndryshim që bëhet në ligj, se është i domosdoshëm, do të doja që t'i bëja ministres një pyetje: veç dëmeve të tërmetit që patëm herën e fundit, kemi pasur edhe tërmete më parë, për të cilët është bërë edhe vlerësimi i dëmeve dhe ndërkohë ka një detyrim të vjetër që ende vazhdon të kalohet nga viti në vit. A është parashikuar kjo në buxhetin për vitin e ardhshëm? Për shembull, unë jam deputet i zonës që mbuloj edhe pjesën e Vranishtit të Kuçit, ku ka pasur një tërmet vjet dhe ato dëme janë vlerësuar. A janë parashikuar detyrimet që ka shteti dhe qeveria për këto dëme? Në zonën time janë dy tërmete të mëparshme, tërmeti i Smokthinës në muajin maj dhe tërmeti i Kuçit në muajin dhjetor. Për tërmetin e Kuçit kanë ardhur vlerësimet nga prefektura dhe bashkia te Drejtoria e Emergjencave. A keni menduar ta parashikoni në buxhetin e vitit që do të vijë për të mbuluar edhe dëmet e këtyre tërmeteve?

Faleminderit!

(Mungesë audio)

Arben Ahmetaj – Buxheti i shtetit i ka paguar dëmet për Zharrëzën, ministre. Pjesa e Bankers-it nuk është paguar dhe zonja Dhima vazhdon i kërkon buxhetit të shtetit pjesën e Bankers-it, kështu që unë nuk ia jap të drejtën e kësaj pyetjeje ndaj jush, sepse nuk është e drejtë për çështjen sot dhe për buxhetin e shtetit.

Zonja Dhima, mund ta bëni si pyetje në seancë, ministrja do të jetë në Uashington dhe përgjigjen do t'jua kthejë me mesazh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Buxheti i ka paguar detyrimet e veta, mos e shikoni atë si lopë për ta mjelë për gjëra që janë jashtë sferës së përgjegjësisë së qeverisë dhe shtetit!

Anila Denaj – Në fakt, është e drejtë ajo që thoni ju, zoti kryetar, buxheti i shtetit i ka kryer detyrimet ndaj kësaj zone, ndërkohë që fondi, i cili krijohet nga kompania “Bankers”, nuk e ka mbaruar detyrimin e tij.

Në raport me kërkesën tuaj, zoti Sinaj, më lejoni të informohem nga drejtoria përgjegjëse, e cila, në dijeninë tonë ka fonde buxhetore të çelura, por respektimin e detyrimeve për pagesat, e kanë ata për ta ndjekur. Ne do të informohemi nga ana jonë për këto elemente që përmendët në çfarë pike janë dhe do t’ju kthejmë përgjigje.

Arben Ahmetaj – Pyesni Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, zonja Ministre, mos i merrni përsipër të gjitha vetë, se keni një dynja me punë. Mjafton të na dërgoni një letër shoqëruese të përgjigjes së asaj ministrie që t’ia japim në dorë zonjës Dhima, e cila të shkojë më pas në zonën e vet elektorale dhe t’u kthejë përgjigje banorëve për çështjet që pyet vazhdimisht. Edhe unë i kthej të njëjtën përgjigje gjithmonë, por sigurisht ajo e ka detyrë funksionale dhe përgjegjësi si deputete shumë e angazhuar me zonën, ngaqë sa herë shkon në Zharrës, në legjitimitet të tyre, ata i kërkojnë të njëjtën gjë, por kjo është përgjegjësi e Bankers-it.

Ismet Beqiraj – Faleminderit!

Edhe unë kam një pyetje ndoshta jashtë objektit të këtij akti normativ që po diskutojmë. Në vazhdim edhe të pyetjes së kolegut Sinaj, jo vetëm për tërmetet, por ka pasur edhe ngjarje të tjera të ndodhura më parë, si: shkarje, dëmtim të banesave apo djegie aksidentale të shtëpive dhe emergjencat civile. Edhe pse janë bërë të gjitha vlerësimet nga organet e vetëqeverisjes lokale në bashkëpunim me prefekturat, akoma ka qytetarë që nuk e kanë marrë vlerësimin aq sa është vlerësuar. Do t’ju lutesha që kjo të parashikohet.

Po diskutojmë këtë akt normativ dhe mirë bëjmë që do të miratojmë, për një emergjencë kombëtare që ndodhi si tërmeti i disa javëve më parë, por kemi edhe ngjarje të tilla si familje që u janë djegur shtëpitë dhe ende nuk kanë marrë dëmshpërblimin sipas vlerësimit të miratuar nga institucionet përkatëse duke filluar nga ato të vetëqeverisjes deri tek ato në qendër.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, kjo është një çështje jashtë temës së ditës. Do t’ju lutesha që ndërkohë që deputeti bëri një pyetje, t’i përgjigjeni gjatë kësaj periudhe deri në fund të muajit me shkrim nga ministria juaj.

Unë kam të njëjtën pyetje, zonja ministre: sa janë dëmet e tërmetit të referuar në aktin normativ? Në dijeninë time, është bërë një vlerësim specifik dhe total. A ka ndonjë nominacion buxheti për dëmshpërblim në aktin normativ që kaluam për t’i ndihmuar qytetarët për rindërtim, ndërtim dhe rikonstruksion?

Një merak tjetër që kam është: ju iu referuat nenit 1 ku thuhet se përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Ne nuk ndërhyjmë dot për ta përmirësuar aktin për shkak të Kushtetutës. Meraku im është që mund të ketë fenomene kur rindërtohet banesa e prishur dhe një qytetar mund të kalojë përtej sipërfaqes që ka sot dhe mund të ndërtojë dyfishin e sipërfaqes. Do të duhej të vihej një kufizim këtu. Do t'ju lutesha që kur të bëhet vendimi i qeverisë, të jetë një nga pikat ku të shkruhet qartë për sipërfaqet siç kanë qenë, jo sipërfaqe të shtuara. Nuk e di nëse ma kuptove merakun. Përgjigjen për pyetjen e parë na e dërgoni me shkrim.

Anila Denaj – Lidhur me shqetësimin, për të mbetur brenda një kuadri si buxhetor ashtu dhe brenda parametrave të lejeve, më lejoni të jap referencën e situatës në Korçë, ku rindërtimi i shtëpive u bë sipas një modeli të fiksuar me një buxhet mesatarisht 20-25 mijë euro dhe me parametra të kontekstit të hapësirave optimale, por brenda një formati sipërfaqësor të ruajtjes së standardit. I njëjti format po përdoret edhe në këtë situatë për evidentimin e atyre shtëpive që janë bërë të pabanueshme në adresimin e kërkesës për ndihma edhe nga institucionet ndërkombëtare.

Ndërkohë, do të preferoja të flisja për efektet buxhetore të tërmetit, në ardhje të kërkesës nga ministria përkatëse, nga Fondi i Emergjencave. Ata kanë një buxhet prej 130 milionë lekësh që është i pamjaftueshëm, në gjykimin tonë, për atë që do të parashikojnë. Në momentin që kjo kërkesë vjen formalisht, ne mund t'i referohemi fondit rezervë që sot shkon 500 milionë lekë me këtë akt normativ për kalime të mëtejshme, por brenda aspektit formal.

Arben Ahmetaj – Përgjigja është që nuk ka ende një shifër të zyrtarizuar të dëmeve.

Anila Denaj – Formal nuk ka, ndërkohë, ka një evidencë për vlerësim të disa elementeve, siç thashë më parë, shtëpi të pabanuara dhe dëmet, të cilat janë aktualisht duke u diskutuar së brendshmi.

Arben Ahmetaj –Faleminderit!

Zoti zëvendësministër, ju erdhi përgjigja për shifrën?

Elton Haxhi - Tvsh-ja në import, për mendimin tim, duhet parë bashkë me tvsh-në e brendshme...

Arben Ahmetaj –Nuk të kërkova këtë, të kërkova importin e energjisë elektrike TVSH -në e kalkuloj vet pastaj.

Elton Haxhi - Po të jap direkt efektin në TVSH.

Arben Ahmetaj – Dua importin e energjisë.

Elton Haxhi – Atëherë, duhet të presësh.

Kam direkt shifrën e tvsh-së. Plus 2 miliardë në import, minus 1 miliard e brendshme.

Arben Ahmetaj – Minus 1 miliard i brendshëm, mos u ngatërro me investimet!

Plus një miliard e brendshme është konsekuencë e investimit të kreditueshmes, të pagueshmes, mos e ngatërro me të brendshmen, se nuk janë e njëjta gjë. Ti e di shumë mirë, se je profesionist i vjetër. Mos më sill dy shifra, që nuk krahasohen, 2 miliardë në import, që janë të pastra TVSH, dhe 1 miliard të brendshme që janë konsekuencë e një zinxhiri.

Elton Haxhi – Po flasim për prodhim energjie.

Arben Ahmetaj – Po, por për këtë kur kalkulohet 1 miliard, tvsh-ja i bie të ishte plus 1 miliard me këtë që më thua, por nejtë, nuk ka rëndësi.

Dua, që me lejen e ministres t’i kërkoj Endrit një kalkulim, meqë ju e bëni. Endrit, historia e dëmit që bën prodhimi i energjisë duhet të përcaktohet edhe në një metodologji tjetër, që do të duhet ta diskutoni brenda Ministrisë së Financave. Në qoftë se keni nevojë për ndihmën tonë, por unë besoj që s’e keni këtë nevojë, pasi jeni të gjithë të duhurit atje, energjia është produkt i ndërmjetëm, pra, në vitin 2019 nuk ka munguar në ekonomi, pavarësisht se nuk është prodhuar, është blerë. Pra, duhet edhe një metodologji tjetër që të mos na justifikojë në ndër vite për prodhimin e energjisë. Unë jam i bindur që ti e kupton se çfarë po kërkoj. Energjia është produkt i ndërmjetëm, kur mungon në ekonomi, është histori tjetër, kur zëvendësohet nga importi, është histori tjetër dhe kur prodhohet në vend, është gjithashtu histori tjetër. Efektet, sigurisht nuk janë të njëjta, por ai është produkt i ndërmjetëm i pamunguar në zinxhirin e ekonomisë dhe në metodologjinë tonë, madje po t’u hynim përlllogaritjeve me gjithë primet që paguajmë me PPP-të, krahasuar me atë që shpenzojmë në import, mund të dilte “Nuk e di”, por nuk dua t’i hyj këtij diskutimi teknik tani. Merre si detyrë qoftë institucionale, qoftë miqësore, se do t’i duhet si kësaj administrate, dhe asaj pasardhëse. Dakord? Do të ma thuash këtë kur të takohemi ndonjëherë rastësisht.

Faleminderit!

Ka qëndrim tjetër për aktin 3? Nuk ka.

Të falënderoj, zonja Ministre! Merakun për vendimin e qeverisë të VKM-ja për hapësirat, besoj që do ta reflektoni.

Votojmë në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Përgatisni raportin për seancën.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti